



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANE NABAVKE

Nr./Br.

968-970/10

Datë/Datum.

10.12.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.968/20

970/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenovic - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: "AgriBau"SH.P.K-Prishtinë, dhe OE: N.P.T "Haxhijaha"SH.P.K-Rahovec, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me kultivator për fermer" , me nr. të prok: 616-20-6958-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prishtinë" , më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "AgriBau"SH.P.K-Prishtinë dhe OE N.P.T "Haxhijaha"SH.P.K-Rahovec, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me kultivator për fermer" , me nr. të prok: 616-20-6958-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prishtinë".

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /AK/- "KK-Prishtinë" ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje e tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë, dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizimi me kultivator për fermer" , me nr. të prok: 616-20-6958-1-1-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "AgriBau"SH.P.K-Prishtinë dhe OE N.P.T "Haxhijaha"SH.P.K-Rahovec, aprovojen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të tregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues "AgriBau" SH.P.K-Prishtinë dhe OE N.P.T "Haxhijaha"SH.P.K-Rahovec, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 18.11.2020 me nr. 968/20, dhe me 18.11.2020 me nr. 970/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me kultivator për fermer", me nr. të prok: 616-20-6958-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prishtinë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe 7 të LPP-së te ankesa me nr. 968/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 pika 2 dhe pika 7 të LPP-së , te ankesa me nr. 970/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 25.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "AgriBau" Sh.p.k-Prishtinë

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se AK ka përcaktuar kërkesa tek kriteret e përzgjedhjes ne FDT, me shkelje te ligjt te prokurimit, diskriminim dhe favorizim te kompanive te caktuara,

si ne vijim: 1.)” Kërkohet qe kompania te këtë minimum 10 punëtorë” Kjo është një kërkësë diskriminuese e cila është kërkuar pa kurrfarë arsy. Pse nuk do te mundemi ne p.sh. si kompani qe kemi 8 punëtorë, te bëjmë furnizimin me 50 kultivator, kur ne kemi kontrata te përfunduara me sukses ku kemi furnizuar nga 300 kultivator me një furnizim. Pra shkurt te thuhet kjo kërkësë është absolutisht e padrejte dhe ne kundërshtim me ligjin e LPP. 2.) Kërkohet “Menaxher i projektit – Agronom i diplomuar min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit” Çfarë lidhje ka kjo me furnizimin me moto kultivator? Ne si kompani kemi stafin e profesionalizuar për makineri dhe sërvisin tonë ku gjatë periudhës se garacionit dhe me rastin e liferimit do te bëjmë trajnimin e fermerëve përfitues për mënyrën e përdorimit te pajisjes dhe këtu nuk ka te beje absolutisht agronomi. 3.) OE duhet te ofroj “Inxhinier i bujqësisë drejtimi lavërtari pemëtari, dy vite përvojë pune” Ky është vetëm një furnizim dhe ne nuk kemi për detyre t’ua punojmë token përfitueseve, por vetëm te i furnizojmë me moto kultivator, prandaj këto kërkesa janë skajshmërisht diskriminuese dhe favorizuese. Dhe ka te beje me shkelje te LPP. Eksperti shqyrtaues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne nenin 51 par. 1 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; Të gjitha kriteret e përgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose përmarrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji”. Autoriteti kontraktues sigurisht ka marr për bazë këto nene, mirëpo, kur ka hartuar njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit si material themelore, ne bazë te cilët operatoret ekonomik do te krijojnë tender e tyre, autoriteti kontraktues, duhet te dije me se miri, sepse ata janë te obliguar ti njohin dhe ti përbushin nevojat për autoritetin kontraktues, ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-se, ne atë mënyrë, qe aq sa është e mundshme te gjitha dokumentet qe duhet te dorëzojnë operatoret ekonomik me dosjen e tenderit, te kufizohen vetëm ne aq dokumente, sa është i nevojshëm për ti lejuar autoriteti kontraktues qe te verifikoj se operatori ekonomik, i përbush kriteret minimale te përgjedhjes te saktësuar ne njofsim për kontrate dhe dosje te tenderit dhe qe janë ne pajtim me nenet 65-70 te LPP-se. Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit ose me fjale tjera ai/ajo është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te tenderit, kritereve te përgjedhjes, si dhe kritereve te dhënieve, ndërsa specifikimet teknike do te përgatiten nga struktura te specializuara ne çështjen qe do te prokurohet, brenda autoriteti te kontraktues (mirëpo, specifikat teknike, duhet të janë në raport të drejt me kriteret e

përzgjedhjes). Eksperti shqyrtues sqaron, se autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura e hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €, kurse tek aneksi 1 i FDT-se përveç specifikave teknike te pajisjeve ka kërkuar si ne vijim: “**TRAJNIMI, KËSHILLËDHËNJA, DHE NDIHMA PROFESIONALE PËR PËRFITUES**

Mbajtja e trajnimit për funksionalitetet e makinerisë me rastin e përfitimit, Këshillë dhënia dhe ndihma virtuale/telefonike pas pranimit të makinerisë nga bujku përfitues për së paku 13 muaj nga. Së paku një këshillëdhënës i specializuar në Lavërtari dhe permtari”, duka marr parasysh këtë përshkrim, kurse dosja e tenderit është furnizim me pajisje për fermer, ndoshta AK është dashtë te ndaj ne Lot-e këtë procedurë te prokurimit, ne mënyrë qe te mos detyrohen kompanitë te cilat bëjnë furnizimin/livrimin me pajisje te detyrohen te angazhojnë eksperte te fushës se ngushtë për këshillim nga një fushe specifike e ngushte, sepse kompanitë qe merren me shite-blerjen e makinerisë, nuk janë te obliguar te posedojnë ekspert te fushës se ngushe për shërbime specifike. Mirëpo, pavarësisht kësaj AK ka mundësuar qe staf profesional te prezantohet edhe me kontrate/marrëveshje për angazhim lidhur me këtë projekt, mirëpo kjo mund te ndikoj ne rritjen e çmimi te ofertave. Ndërsa numri i punëtorëve te kërkuar min. 10 punëtorë, ne rastin e kontratave për furnizim është ne kundërshtime me nenin 69 par. 2 pika 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5 te LPP-se sepse specifikisht, gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënieve së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, shprehimisht nuk thuhet se AK mund te kërkoj numrin e te punësuarave, prandaj AK gjithashtu gjate hartimit te kritereve te përzgjedhjes nuk ka respektuar nenin 1 par. 1 te LPP-se, po citoj: “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tillë”, si dhe nenin 7 par. 2 te LPP-se , po citoj: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnje aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pikë janë të qëndrueshme.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se AK ka përcaktuar kërkesa tek kërkesa përshtatshmëria profesionale shkelje te ligjt te prokurimit, diskriminim dhe favorizim te kompanive te caktuara, si ne vijmë: 4.) Kërkohet “Certifikata ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2015”. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën

elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne nenin 71 par. 4 te LLP, ku thotë: “Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”, qe do te thotë se OE e interesuar për këtë procedure te prokurimit nëse duan te marrin pjese duhet te jene te licencuar me këto ISO standard, prandaj nëse AK vlerëson se pajisjet te cilat synon ti prokuroj duhet te jene me cilësi sipas këtyre standardeve mund te kërkoj tek specifikimi teknik ne Aneksin 1 ose/dhe mund te kërkoj këto ISO standarde tek Kërkesat mbi mundësitet teknike dhe/ose profesionale ne FDT, prandaj AK nuk ka respektuar nenin 7 par. 6 të LPP-së, sepse zyrtari i prokurimit gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, do të sigurojnë: (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik”, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriteri të tillë. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se AK ka përcaktuar ne FDT si ne vijim: “Afati kohore për fillimin dhe ose përfundimin e kontratës: 30 dite”. Afati kohore për liferim është shume i shkurtër për furnizimin te kultivatorëve për shkak se nuk prodhohet ne Kosovë dhe nevojiten 2 muaj kohë për prodhimin e tij. Është diskriminim për ne dhe shumë kompani te tjera sepse nuk mund te bëhet liferimi i tyre për 30 ditë. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit, ne baze te nevojave te veta, vlerës se kontratës, si dhe hulumtimit dhe analizimit te tregut përcakton edhe periudhën kohore përlëvrim te furnizimeve, prandaj duke pas parasysh se OE ankues nuk ka dhënë një sqarim me te pote përvëç se kërkohet 2 muaj kohe për prodhimin e këtyre pajisjeve, pastaj procedurat e importimi te këtyre pajisjeve etj., Duke u bazuar ne pretendimin detal te OE ankues dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.


Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues NPT “Haxhijaha” Shpk – Rahovec

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 pika 2 dhe 7 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit ka ngritur ne platformën

elektronike e-prokurimi njoftimin për kontrate AK ne këtë aktivitet te prokurimit me date 30.10.2020, kurse OE ankues nuk ka parashtruar fare kërkesë për rishqyrtim pran AK as ne platformën elektronike e-prokurim, eksperti shqyrtues kërkon sqarim nga AK lidhur me dorëzimin e kërkesë për rishqyrtim, ndërsa AK jep ketë sqarim, po citoj: "Ju njoftoj se OE Haxhijaha nuk ka bere kërkesë për rishqyrtim për projektin Furnizimi me kultivator, as përmes platformës se E-prokurimit, e as përmes e-mail-it", prandaj OE ankues nuk ka vepruar ne pajtim me nenin 108/A par. 3 pika 3.1 te LPP-së, po citoj: "3.1. në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave";, dhe ka vepruar kundërshtim me nenin 4 par. 4.1 pika (a), Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, po citoj: "Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave", si dhe ne kundërshtim me nenin 5 par. 1 te LPP-se, po citoj: "Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjeter me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit". Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme OE ankues nuk ka arrit te kap afatin kohorë ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së, për te parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK dhe pretendimet e palës ne ankesë, nuk ka qenë e mundur te trajtohen nga eksperti shqyrtues sepse OE ankues, nuk ka ndjekur afatit ligjore tek autoriteti kontraktues dhe nuk hyn ne shqyrtim.



Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues, aprovojen si të bazuar, dhe rekomandon qe autoriteti kontraktues të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konfirmo nenit 53.7 të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik: "AgriBau"SH.P.K-Prishtinë, me datë 25.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar; Lidhur me Raportin e ekspertit Shqyrtues te OSHP-se për aktivitetin e prokurimit Furnizim me kultivator për fermer nr. prokurimi 616-20-6958-1-2-1 i iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, Pajtohemë Pjesërisht. Pajtohemë ne përgjigjën e pretendimit nr. 1 nga ana e ekspertit Shqyrtues te OSHP-se, Pajtohemë ne përgjigjën e pretendimit nr. 2 nga ana e ekspertit Shqyrtues te OSHP-se, Ndërsa sa i përket përgjigjes ne pretendimin nr. 3 eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje se ne nuk kemi sqaruar sa duhet se afati kohore për liferim prej 30 dite është shume i shkurtër, ne mendojmë se ky pretendim i yni qëndron pasi qe ne baze te praktikave te mëhershme disa vjeçare me kompanitë te ndryshme prodhuese kemi marrur përgjigje se nuk ka mundësi te prodhimit te këtyre kultivatorëve ne këtë afat kohore duke pas parasysh edhe transportin e tyre. Po ashtu kjo mund te vërtetohet edhe nga praktikat e mëhershme aktivitetet e prokurimit te komunave dhe institucioneve tjera për këtë lloje furnizimi si p.sh; Kuvendi Komunal Klinë aktiviteti i prokurimit nr. 634205791121 afati kohore 6 muaj, Kuvendi Komunal Podujeve aktiviteti i prokurimit nr. 615-20-7784-1-1-1 afati kohore 90 dite, Kuvendi Komunal Lipjan aktiviteti i prokurimit nr. 613-20-5965-1-2-1 afati kohore 60 dite, Kuvendi Komunal Prizren aktiviteti i prokurimit nr. 622-20-1805-1-1-1 afati kohore 90 dite. Kështu qe ne mendojmë se afati i shkurtër kohore prej 30 dite qe është vendosur nga AK është një faktor i qarte favorizues për ndonjë kompani te caktuar e cila mund ti këtë ne stok një sasi te tille te kultivatorëve. Si dhe duke u bazuar ne sezonin te cilën gjendemi nuk ka ndonjë urgjence për te arsyetuar këtë afat te shkurtër kohore. Me respekt, Naim Berisha.

Operatori Ekonomik: N.P.T "Haxhijaha"SH.P.K-Rahovec, me datë 27.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje te Nderuar, sikurse Ju kemi njoftuar edhe me herët, me 12.11.2020 ne kemi dërguar email AK (te bashkangjitur) ne lidhje me shqetësimet tona si kompani ne lidhje me tenderin ne fjale dhe ne këtë email po ashtu kemi njoftuar AK se shqetësimet e njëjta do te adresojmë edhe nëpërmes platformës se e-prokurimit duke parashtruar kërkësë për rishqyrtim. Sidoqoftë, kërkësen për rishqyrtim nuk kemi mundur te bëjmë pasi një OE tjeter veçse kishte bere këtë kërkësë edhe pse afati i kërkësave për rishqyrtim ishte ende i hapur, pra

deri me datën 13.11.2020. Pra, nuk qëndron deklarata e AK se "Ju njoftoj se OE Haxhijaha nuk ka bere kërkesë për rishqyrtim për projektin Furnizimi me kultivator, as përmes platformës se E-prokurimit, e as përmes e-mail-it". Duke pasur parasysh se nuk kemi pasur mundësi te bëjmë kërkesë për rishqyrtim dhe duke pasur evidence me shkrim drejtuar AK për shqetësimet tona ne lidhje me këtë tender brenda afatit e përcaktuar për rishqyrtime, atëherë kërkojmë nga autoriteti i Juaj te trajtoje si te mirëqene kërkesën tone me email drejtuar AK. Pavarësisht, ne si kompani PAJTOHEMI me mendimin e ekspertit shqyrtues duke pasur parasysh se kërkesat tone si kompani janë gati sa te njëjta me kërkesat e OE tjeter ankues. Për çdo informate shtese jemi ne dispozicionin tuaj. Me respekt,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Përgjigje lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AgriBau" Sh.p.k-Prishtinë,

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AgriBau" Sh.p.k-Prishtinë, se AK ka përcaktuar kërkesa tek kriteret e përzgjedhjes në FDT, me shkelje të ligjit të prokurimit, diskriminim dhe favorizim të kompanive të caktuara, si në vijim: 1.)" Kërkohet qe kompania te këtë minimum 10 punëtorë". OE ankues shton se kjo është një kërkesë diskriminuese e cila është këruar pa kurrfarë arsy. Pse nuk do te mundemi ne p.sh. si kompani qe kemi 8 punëtorë, te bëjmë furnizimin me 50 kultivator, kur ne kemi kontrata te përfunduara me sukses ku kemi furnizuar nga 300 kultivator me një furnizim. Pra, shkurt të thuhet kjo kërkesë është absolutisht e padrejte dhe ne kundërshtim me ligjin e LPP. 2.) Kërkohet "Menaxher i projektit – Agronom i diplomuar min. 3 vite përvjetore pune pas diplomimit" Çfarë lidhje ka kjo me furnizimin me moto kultivator?. Ne si kompani kemi stafin e profesionalizuar për makineri dhe sërvisin tonë ku gjatë periudhës se garacionit dhe me rastin e liferimit do te bëjmë trajnimin e fermerëve përfitues për mënyrën e përdorimit te pajisjes dhe këtu nuk ka te beje absolutisht agronomi. 3.) OE duhet te ofroj "Inxhinier i bujqësisë drejtimi lavërtari pemëtari, dy vite përvjetore pune" Ky është vetëm një furnizim dhe ne nuk kemi për detyre t'ua punojmë token përfitueseve, por vetëm te i furnizojmë me moto kultivator, prandaj këto kërkesa janë skajshmërisht diskriminuese dhe favorizuese. Dhe ka te beje me shkelje te LPP.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se neni 51 par. 1 i LPP-së ka përcaktuar që: "Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhëni e një

kontrate; Të gjitha kriteret e përgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përvç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues sigurisht ka marr për bazë këto nene, mirëpo kur ka hartuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si material themelor, në bazë të cilët operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre, autoriteti kontraktues duhet të dijë më së miri sepse ata janë të obliguar ti njohin dhe ti përbushin nevojat për autoritetin kontraktues në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, në atë mënyrë që aq sa është e mundshme të gjitha dokumentet që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomik me dosjen e tenderit, të kufizohen vetëm në aq dokumente, sa është i nevojshëm për ti lejuar autoriteti kontraktues që të verifikoj se operatori ekonomik i përbush kriteret minimale të përgjedhjes të saktësuar në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit dhe që janë në pajtim me nenet 65-70 të LPP-së. Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit ose me fiale tjera ai/ajo është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te tenderit, kritereve te përgjedhjes, si dhe kritereve të dhënies. Ndërsa specifikimet teknike do të përgatiten nga struktura të specializuara në çështjen që do të prokurohet, brenda autoritetit kontraktues (mirëpo, specifikat teknike duhet të jenë në raport të drejt me kriteret e përgjedhjes). Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €, kurse tek aneksi 1 i FDT-se përvç specifikave teknike të pajisjeve ka kërkuar si në vijim:

“Trajnim, Këshillë dhënia dhe Ndihma Profesionale për Përsitues, Mbajtja e trajnimit për funksionalitetet e makinerisë me rastin e përsitimit, Këshillë dhënia dhe ndihma virtuale/telefonike pas pranimit të makinerisë nga bujku përsitues për së paku 13 muaj nga së paku një këshillëdhënës i specializuar në Lavërtari dhe perimtari”.

Në njëren anë duke marr parasysh këtë përshkrim dhe në anën tjetër duke pasur parasysh që dosja e tenderit është furnizim me pajisje për fermer, atëherë mënyra më e mirë do të sihte që AK ta ndaj në Lot-e këtë procedurë të prokurimit, në mënyrë që të mos detyrohen kompanitë të cilat bëjnë furnizimin/livrimin me pajisje të detyrohen të angazhojnë ekspert të fushës së ngushtë për këshillim nga një fushe specifike e ngushtë. Sepse kompanitë që merren me shit-blerjen e makinerisë nuk janë te obliguara të posedojnë ekspert të fushës së ngushtë për shërbime specifike. Pavarësisht kësaj, AK ka mundësuar që stafi profesional të prezantohet edhe me kontratë/marrëveshje për angazhim lidhur me këtë projekt, mirëpo kjo mund të ndikoj në rritjen e çmimi të ofertave. Ndërsa numri i punëtorëve të kërkuar min. 10 punëtor, në rastin e kontratave për furnizim është në kundërshtime me nenin 69 par. 2 pika 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5 të LPP-së sepse

specifisht, gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, shprehimisht nuk thuhet se AK mund te kërkoj numrin e te punësuarave. Prandaj, AK gjithashtu gjatë hartimit të kritereve të përzgjedhjes nuk ka respektuar nenin 1 par. 1 të LPP-se, ku thuhet:

“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”.

Gjithashtu, AK nuk ka pasur parasysh edhe nenin 7 par. 2 të LPP-së, ku thuhet:

- “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”.

Paneli Shqyrtaues konform ekspertit shqyrtaues duke u bazuar në këto fakte, vlerëson se pretendimi i palës në ankesë në këto pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjeter të OE ankues “AgriBau” Sh.p.k-Prishtinë, se AK ka përcaktuar kërkesa tek kërkesat përshtatshmëria profesionale shkelje te ligjit te prokurimit, diskriminim dhe favorizim te kompanive te caktuara, si ne vijmë: 4.) Kërcohët “Certifikata ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2015”.

Paneli Shqyrtaues konform ekspertit shqyrtaues sqaron se në nenin 71 par. 4 të LPP-së është përcaktuar: “Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”. Nga kjo rrjedh se OE e interesuar përkëtë procedure të prokurimit nëse duan të marrin pjesë duhet të jenë të licencuar me këto ISO standarde. Prandaj, nëse AK vlerëson se pajisjet të cilat synon ti prokuroj duhet të jenë me cilësi sipas këtyre standardeve, mund të kërkoj tek specifikimi teknik në Aneksin 1 ose/dhe mund të kërkoj këto ISO standarde tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne FDT. Andaj, AK nuk ka respektuar nenin 7 par. 6 të LPP-së, sepse zyrtari i prokurimit gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, do të sigurojnë: (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik”, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriteri të tillë. Pra, pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AgriBau” Sh.p.k-Prishtinë, se AK ka përcaktuar në FDT, si në vijim: “Afatet kohore për fillimin dhe ose përfundimin e kontratës: 30 dite”. Afati kohore për

liferim është shume i shkurtër për furnizimin te kultivatorëve për shkak se nuk prodhohet ne Kosovë dhe nevojiten 2 muaj kohë për prodhimin e tij. Është diskriminim për ne dhe shumë kompani te tjera sepse nuk mund te bëhet liferimi i tyre për 30 ditë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se zyrtari i prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit, ne baze te nevojave te veta, vlerës se kontratës, si dhe hulumtimit dhe analizimit te tregut përcakton edhe periudhën kohore për lëvrim te furnizimeve, prandaj duke pas parasysh se OE ankues nuk ka dhënë një sqarim me te plote përveç se kërkohet 2 muaj kohe për prodhimin e këtyre pajisjeve, pastaj procedurat e importimi te këtyre pajisjeve etj., Duke u bazuar në pretendimin detal të OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi për këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues NPT “Haxhijaha” Shpk – Rahovec

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NPT “Haxhijaha” Shpk – Rahovec, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 pika 2 dhe 7 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka ngritur në platformën elektronike e-prokurimi njoftimin për kontratë me date 30.10.2020, kurse OE ankues nuk ka parashtruar fare kërkësë për rishqyrtim pranë AK-së as në platformën elektronike e-prokurim. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues kërkon sqarim nga AK lidhur me dorëzimin e kërkësë për rishqyrtim, ndërsa AK jep ketë sqarim: “Ju njoftoj se OE Haxhijaha nuk ka bërë kërkësë për rishqyrtim për projektin Furnizimi me kultivator, as përmes platformës se E-prokurimit, e as përmes e-mail-it”, prandaj OE ankues nuk ka vepruar ne pajtim me nenin 108/A par. 3 pika 3.1 te LPP-së, ku thuhet: “3.1. në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”; dhe ka vepruar kundërshtim me nenin 4 par. 4.1 pika (a), Rregullat për paraqitje te kërkësës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, ku thuhet: “Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”, si dhe ne kundërshtim me nenin 5 par. 1 te LPP-se, ku thuhet: “Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne këto fakte, OE ankues nuk ka arrit te kap afatin kohor në pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së për të parashtruar kërkësë për rishqyrtim pranë AK dhe pretendimet e palës në ankesë, nuk ka qenë e mundur të trajtohen.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, konsideron se autoriteti kontraktues ka përpiluar dosjen e tenderit në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Andaj,

obligohet AK që gjatë përmirësimit të dosjes së tenderit ti merr parasysh sqarimet e ekspertit shqyrtues dhe të bëjë zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konfirmo nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë ndryshimit dhe përmirësimit të dosjes duhet të ketë parasysh edhe nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), ku është përcaktuar se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptoj në lidhje me: (i). vlerën e parashikuar të kontratës, dhe (ii). përdorim të drejtë të fondeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Prishtinë”;
- 1x1 OE “AgriBau”SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 OE N.P.T“Haxhijaha”SH.P.K-Rahovec;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.